DEKRETI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, datë 05 nëntor 2004, nr.301
Përvetësimi i marrëveshjes sindikaliste për Forcat e policisë dhe të skemës së masës për Forcat e policisë me organizim ushtarak në lidhje me dyvjeçarin ekonomik 2004-2005.

FORCAT E POLICISË ME ORGANIZIM CIVIL
PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Mbasi shikoi nenin 87 të Kushtetutës;
Mbasi shikoi dekretin legjislativ të datës 12 maj 1995, nr. 195, i cili përmban «Procedurat për disiplinimin e përmbajtjes së marrëdhënieve të punësimit të personelit të Forcave të policisë dhe të Forcave të armatosura»;
Mbasi shikoi dispozitat e neneve 1, 2 dhe 7 të dekretit legjislativ të sipërpërmendur nr. 195 të vitit 1995, të cilat disiplinojnë procedurat negociuese dhe përgatitore të marrëveshjes, për të filluar, për të zhvilluar dhe për të përfunduar në mënyrë të njëkohësishme, për vënien në zbatim të dekreteve të veçanta të Presidentit të Republikës, të cilat kanë të bëjnë përkatësisht me personelin e Forcave të policisë me organizim civil dhe me organizim ushtarak, si edhe të personelit të Forcave të armatosura, me përjashtim të drejtuesve përkatës civilë dhe ushtarakë, të personelit të shërbimit dhe ndihmës të shërbimit;
Mbasi shikoi dispozitat e neneve 2 dhe 7 të dekretit legjislativ të sipërpërmendur nr. 195 të vitit 1995, të cilat kanë të bëjnë me mënyrat e krijimit të delegacioneve të palës publike, të delegacioneve sindikaliste dhe të përfaqësuesve të Këshillit qendror të përfaqësimit që marrin pjesë në procedurat negociuese dhe di concertazione si më sipër, përkatësisht për Forcat e policisë me organizim civil (Policia e Shtetit, Trupa e Policisë së Burgjeve dhe Trupa e Policisë Pyjore të Shtetit), për Forcat e Policisë me organizim ushtarak (Arma e Karabinierëve dhe Trupa e Policisë Tatimore - Guardia di Finanza) dhe për Forcat e armatosura;
Mbasi shikoi në mënyrë të veçantë dispozitat që përmban neni 2, paragrafi 1, gërmat a) dhe b), si edhe neni 7 i dekretit legjislativ të sipërpërmendur nr. 195 të vitit 1995, të cilat kanë të bëjnë me procedurat negociuese dhe përgatitore të marrëveshjes, përkatësisht për Forcat e policisë me organizim civil dhe për Forcat e Policisë me organizim ushtarak që janë treguar më sipër;
Mbasi shikoi dekretin e Ministrit për funksionin publik në datën 10 maj 2004, të botuar në Gazetën Zyrtare nr. 112 të datës 14 maj 2004, në lidhje me «Përcaktimi i delegacionit sindikalist, që merr pjesë në bisedimet për përcaktimin e marrëveshjes sindikaliste për dyvjeçarin ekonomik 2004-2005, që ka të bëjë me personelin e Forcave të policisë me organizim civil (Policia e Shtetit, Trupa e Policisë së Burgjeve dhe Trupa e Policisë Pyjore të Shtetit)»;
Mbasi shikoi hipotezën e marrëveshjes sindikaliste që ka të bëjë me dyvjeçarin ekonomik 2004-2005 për personelin jo drejtues të Forcave të Policisë me organizim civil (Policia e Shtetit, Trupa e Policisë së Burgjeve dhe Trupa e Policisë Pyjore të Shtetit), të nënshkruar, në mbështetje të dispozitave të sipërpërmendura të dekretit legjislativ të datës 12 maj 1995, nr. 195, në datën 13 tetor 2004, nga delegacioni i palës publike dhe nga organizatat sindikaliste si më poshtë vijojnë, përfaqësuese në planin kombëtar:
për Policinë e Shtetit:
SIULP;
SAP;
FSP - Lisipo, Sodipo Rinnovamento Sindacale (Ripërtëritja Sindikaliste) per l'UGL;
SIAP;
Federata Konfederata CONSAP - Italia Sicura (Italia e Sigurt) (ANIP - USP);

për Trupën e policisë së burgjeve:
SAPPE;
SINAPPE;
Federata e Sindikatave të Pavarura CNPP - SiAPPe - UGL/FNP;
SiALPe - ASIA;
për Trupën e Policisë Pyjore të Shtetit:
SAPAF;
UGL/Trupa e Policisë Pyjore të Shtetit;
SAPECOFS;
DIRFOR;
Mbasi shikoi skemën e masës së përgatitjes që ka të bëjë me dyvjeçarin ekonomik 2004-2005 për personelin jo drejtues të Forcave të Policisë me organizim ushtarak (Arma e Karabinierëve dhe Trupa e Policisë Tatimore - Guardia di Finanza), të hartuar, në mbështetje të dispozitave të sipërpërmendura të dekretit legjislativ të datës 12 maj 1995, nr. 195, në datën 13 tetor 2004, nga delegacioni i palës publike, nga Komanda e përgjithshme e Armës së Karabinierëve, nga Komanda e përgjithshme e Corpo të Policisë Tatimore - Guardia di Finanza, nga Seksioni i Këshillit Qendror të Përfaqësimit (COCER)i karabinierëve, nga Seksioni i Këshillit Qendror të Përfaqësimit (COCER) i Policisë Tatimore - Guardia di Finanza;
Mbasi shikoi dekretin legjislativ të datës 30 maj 2003, nr. 193, i cili përmban «Sistemin e parametrave të rrogave për personelin jo drejtues të Forcave të Policisë dhe të Forcave të Armatosura, në mbështetje të nenit 7 të ligjit të datës 29 mars 2001, nr. 86»;
Mbasi shikoi ligjin e datës 24 dhjetor 2003, nr. 350 (ligji financiar i vitit 2004);
Mbasi shikoi nenin 17, paragrafi 1, të ligjit të datës 23 gusht 1988, nr. 400, si edhe nenin 7, paragrafi 11, periudha e fundit, të dekretit legjislativ nr. 195 të vitit 1995;
Mbasi shikoi Vendimin e Këshillit të Ministrave, të shpallur në mbledhjen e datës 28 tetor 2004, me anën e të cilit janë miratuar, në mbështetje të nenit 7 të sipërpërmendur, paragrafi 11, të dekretit legjislativ nr. 195 të vitit 1995, mbasi është kryer verifikimi i përputhshmërive financiare dhe në mungesë të vërejtjeve, sikurse është parashikuar në paragrafin 4, të nenit 7 të sipërpërmendur, hipoteza e marrëveshjes sindikaliste që ka të bëjë me personelin jo drejtues të Forcave të Policisë me organizim civil dhe skemën e masës që ka të bëjë me Forcat e Policisë me organizim ushtarak, sikurse janë treguar më sipër;

Sipas propozimit të Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe të Ministrit për funksionin publik, në marrëveshje me Ministrin e Punëve të Brendshme, me Ministrin e Mbrojtjes, me Ministrin e Drejtësisë, me Ministrin e Politikave Bujqësore dhe Pyjore, si edhe me Ministrin e Ekonomisë dhe të Financave;
Dekreton:

Neni 1.
Fusha e zbatimit dhe kohëzgjatja

1. Në mbështetje të nenit 2, paragrafi 1, gërma a), të dekretit legjislativ të datës 12 maj 1995, nr. 195, si edhe të ndryshimeve të mëtejshme, ky dekret zbatohet për personelin e organikës së Policisë së Shtetit, të Trupës së Policisë së Burgjeve dhe të Trupës së Policisë Pyjore të Shtetit, me përjashtim të drejtuesve përkatës dhe të personelit të shërbimit.
2. Ky dekret ka të bëjë me aspektet e rrogave dhe është i vlefshëm për periudhën nga 01 janar 2004 deri në 31 dhjetor 2005.
3. Mbas një periudhe pushimi kontraktor, të barabartë me tre muaj nga data e mbarimit të pjesës ekonomike që rregullohet nga ky dekret, personelit të

parashikuar nga paragrafi 1 i përkon, duke filluar nga muaji pasardhës, një element i përkohshëm i rrogës, i cili është i barabartë me tridhjetë për qind të normës së inflacionit të programuar, që zbatohet për parametrat e rrogave në fuqi. Mbas tre muajsh të tjerë pushimi kontraktor, kjo shumë është e barabartë me pesëdhjetë për qind të normës së inflacionit të programuar dhe dhënia e saj ndërpritet me fillimin e efekteve ekonomike që janë parashikuar nga dekreti i ri i Presidentit të Republikës, i shpallur në mbështetje të nenit 2, paragrafi 1, gërma a), i dekretit legjislativ nr. 195 të vitit 1995.

Neni 2.
Rrogat e reja

1. Duke filluar nga data 01 janar 2004, rrogat e personelit të Forcave të Policisë me organizim civil, të cilat janë përcaktuar nga neni 3, paragrafi 3, i dekretit të Presidentit të Republikës, të datës 18 qershor 2002, nr. 164, janë rritur me masat mujore bruto dhe janë përcaktuar sërish në vlerat vjetore bruto, sikurse janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nivelet	Rritje mujore bruto (Euro)	Rrogat vjetore bruto sipas tabelës (Euro)
IX	33,90	14.844,14
VIII	30,86	13.013,64
VII-bis	29,53	12.216,25
VII	28,19	11.421,14
VI-bis	27,00	10.703,57
VI	25,81	9.984,79
V	24,28	9.067,95

2. Duke filluar nga data 01 janar 2005, vlera e pikës parametrale, që është përcaktuar nga neni 2, paragrafi 4, i dekretit legjislativ të datës 30 maj 2003, nr. 193, është caktuar në masën vjetore bruto të barabartë me 154,50 Euro. Prandaj trajtimi me rroga i personelit të Forcave të Policisë me organizim civil, i cili është paraqitur në tabelën 3 që i bashkëlidhet po të njëjtit dekret legjislativ, është përcaktuar sërish në masat vjetore bruto të paraqitura si më poshtë vijojnë:

Kualifikimet	Parametri	Rrogat vjetore bruto nga data 01 janar 2005 (Euro)
Zëvendëskuestor zëvendësues dhe kualifikimet e barazuara	150,00	23.175,00
Kryekomisar dhe kualifikimet e barazuara	144,50	22.325,25
Komisar dhe kualifikimet e barazuara	139,00	21.475,50
Zëvendëskomisar dhe kualifikimet e barazuara	133,25	20.587,13
Inspektor i lartë NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS) zëvendëskomisari dhe kualifikimet e barazuara	139,00	21.475,50
Inspektor i lartë Nënoficer i Sigurisë Publike (SUPS) (me 8 vjet në kualifikim) dhe kualifikimet e barazuara	135,50	20.934,75

Inspektor i lartë NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS) dhe kualifikimet e barazuara	133,00	20.548,50
Kryeinspektor dhe kualifikimet e barazuara	128,00	19.776,00
Inspektor dhe kualifikimet e barazuara	124,00	19.158,00
Zëvendësinspektor dhe kualifikimet e barazuara	120,75	18.655,88
Kryeintendent (me 8 vjet në kualifikim) dhe kualifikimet e barazuara	122,50	18.926,25
Kryeintendent dhe kualifikimet e barazuara	120,25	18.578,63
Kryeintendent dhe kualifikimet e barazuara	116,25	17.960,63
Nënintendent dhe kualifikimet e barazuara	112,25	17.342,63
Kryeasistent (me 8 vjet në kualifikim) dhe kualifikimet e barazuara	113,50	17.535,75
Kryeasistent dhe kualifikimet e barazuara	111,50	17.226,75
Asistent dhe kualifikimet e barazuara	108,00	16.686,00
Agjent i zgjedhur dhe kualifikimet e barazuara	104,50	16.145,25
Agjent dhe kualifikimet e barazuara	101,25	15.643,13

3. Vlerat e rrogave sikurse në paragrafin 2 përvetësojnë rritjet që u janë caktuar që nga data 01 janar 2004, në mbështetje të paragrafit 1.
4. Trajtimi me rroga, sikurse është përcaktuar sërish nga paragrafi 2, për kuotën e pjesës që ka të bëjë me kompensime (shtesa) plotësuese të posaçme, të grumbulluar që prej datës 01 janar 2005, në vetë trajtimin, në mbështetje të nenit 3, paragrafi 1, të dekretit legjislativ të datës 30 maj 2003, nr. 193, nuk e ndryshon bazën e llogarisë për qëllimet e bazës së pensionit, sikurse është parashikuar nga ligji i datës 29 prill 1976, nr. 177, si edhe nga ndryshimet e mëtejshme, dhe të zbatimit të nenit 2, paragrafi 10, të ligjit të datës 08 gusht 1995, nr. 335, dhe nuk ka efekte të drejtpërdrejta dhe jo të drejpërdrejta mbi trajtimin e përgjithshëm të përfituar, në bazë të dispozitave në fuqi, nga personeli që kryen shërbimin jashtë shtetit.
5. Shumat e përcaktuara nga paragrafët 1 dhe 2 përvetësojnë elementin e përkohshëm të parashikuar të rrogës, në rast pushimi kontraktor, nga neni 2, paragrafi 3, i dekretit të Presidentit të Republikës të datës 18 qershor 2002, nr. 164.

Neni 3.
Efektet e rrogave të reja.

1. Duke mbetur e pandryshuar gjithçka që është parashikuar nga neni 2, paragrafi 4, masat e reja të trajtimit me rroga që rezultojnë nga zbatimi i këtij dekreti me marrëveshje kanë efekt mbi rrogën e trembëdhjetë, mbi trajtimin e zakonshëm të pensionit, normal dhe të privilegjuar, mbi shtesën për vjetërsinë në punë, mbi pagën shtesë ushqimore, që parashikohen nga neni 82 i dekretit të Presidentit të Republikës të datës 10 janar 1957, nr. 3, ose nga dispozitat e

ngjashme, mbi kompensimin e drejtë, mbi ndalesat për sigurimet shoqërore dhe të asistencës dhe në lidhje me kontributet, duke përfshirë ndalesën në llogarinë e hyrjes INPDAP (Institutit të Sigurimeve Shoqërore për Punonjësit e Ndërmarrjeve Shtetërore), ose të tjera të ngjashme, si edhe kontributet e shpërblimit.

2. Përfitimet ekonomike që rezultojnë nga zbatimi i këtij dekreti janë llogaritur plotësisht, në afatet e mbarimit dhe në shumat e parashikuara, për personelin që sidoqoftë ka ndërprerë shërbimin, me të drejtën e pensionit, në periudhën në të cilën është në fuqi kjo hipotezë marrëveshjeje, me përjashtim të gjithë sa është parashikuar nga paragrafi 3. Efekteve të shtesës për vjetërsinë në punë u merren parasysh vetëm ndarjet në intervale që janë maturuar deri në datën e ndërprerjes së shërbimit.

3. Për personelin që sidoqoftë e ka ndërprerë shërbimin në vitin 2004, me të drejtën e pensionit, përfitimet e rrogës që rezultojnë nga zbatimi i këtij dekreti janë llogaritur për qëllimet e përcaktimit të trajtimit me pension, për vitin 2004, në shumat e parashikuara nga neni 2, paragrafi 1, dhe, për vitin 2005, në shumat e mëtejshme mujore bruto që janë paraqitur në vijim, në lidhje me kualifikimin e mbuluar, si edhe me pozicionin ekonomik të parashikuar nga tabela B1, e cila i është bashkëlidhur dekretit legjislativ të datës 30 maj 2003, nr. 193, të cilat përkojnë me ato që janë përcaktuar për përmirësimin e rrogave për vitin 2005 të personelit në shërbim me kualifikim dhe vjetërsi të barabartë:

Kualifikimet dhe pozicionet ekonomike (*)	Niveli	Euro
Zëvendëskuestor zëvendësues	IX	32,98
Kryekomisar	VIII	33,56
Komisar	VIII	31,11
Zëvendëskomisar	VII-bis	29,88
Inspektor i lartë zëvendëskomisar	VII-bis	32,44
Inspektor i lartë NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)me më shumë se 2 vjet e 4 muaj në kualifikim dhe marrës i rritjes së rrogës sipas dekretit legjislativ 53/2001- | | 87/2001- 76/2001	VII-bis	30,88
Inspektor i lartë NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)me më shumë se 2 vjet e 4 muaj në kualifikim dhe jo marrës i rritjes së rrogës sipas dekretit legjislativ | |53/2001- 87/2001- 76/2001	VII-bis	30,88
Inspektor i lartë NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)me më pak se 2 vjet e 4 muaj në kualifikim, por marrës i rritjes së rrogës sipas dekretit legjislativ 53/2001- | |87/2001- 76/2001	VII-bis	30,88 |
Inspektor i lartë NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)me më pak se 2 vjet e 4 muaj në kualifikim dhe jo marrës i rritjes së rrogës sipas dekretit legjislativ 53/2001- | |87/2001- 76/2001	VII-bis	29,77
Kryeinspektor me më pak se 10 vjet në kualifikim	VII	28,88
Inspektor	VI-bis	28,28

Zëvendësinspektor	VI	28,02
Kryeintendent me më shumë se 30 vjet shërbim dhe më shumë se 4 vjet në kualifikim	VI-bis	27,61
Kryeintendent me më shumë se 30 vjet shërbim dhe më pak se 4 vjet në kualifikim	VI-bis	27,61
Kryeintendent me më pak se 30 vjet shërbim dhe më shumë se 4 vjet në kualifikim	VI-bis	27,61
Kryeintendent me më pak se 30 vjet shërbim dhe më pak se 4 vjet në ualifikim	VI-bis	26,61
Intendent	VI	26,02
Nënintendent	VI	24,23
Kryeasistent me më shumë se 16 vjet shërbim dhe më shumë se 4 vjet në kualifikim	V	26,32
Kryeasistent me më shumë se 16 vjet shërbim dhe më pak se 4 vjet në kualifikim	V	25,43
Kryeasistent me më pak se 16 vjet shërbim dhe më pak se 4 vjet në kualifikim	25,43	
Asistent	V	23,87
Agjent i zgjedhur	V	22,31
Agjent	V	21,44

(*) Janë ripërfshirë kualifikimet që u përkasin forcave të tjera të policisë me organizim civil, si edhe kualifikimet e barazuara të roleve të tjera të Policisë së Shtetit dhe të Trupës së Policisë Pyjore të Shtetit.

4. Për qëllimet e përcaktimit të trajtimit me pension, shumat e tabelës së paraqitur në paragrafin 3 nuk prodhojnë efekte mbi rritjen në gradë dhe rrogë dhe mbi përfitimet që janë paraqitur në nenin 3, paragrafi 1, të dekretit legjislativ të datës 30 maj 2003, nr. 193, që, duke filluar nga data 01 janar 2005, përmblidhen në rrogën që bazohet mbi sistemin e parametrave.

5. Pagesa e rrogave të reja që lindin nga zbatimi i këtij dekreti kryhet, në mënyrë të përkohshme dhe me përjashtim të barazimit, në mbështetje të nenit 172 të ligjit të datës 11 korrik 1980, nr. 312, përsa i përket likuidimit të shpejtë të trajtimit të ri ekonomik.

6. Masat e reja të trajtimit me rrogë, sikurse janë parashikuar në nenin 2, nuk kanë efekt mbi përcaktimin e masave për orët e shpërblimit për punën e zhvilluar jashtë orarit të shërbimit. Masat bruto për orët e shpërblimit për punën e zhvilluar jashtë orarit të shërbimit mbeten ato që janë përcaktuar nga neni 4, paragrafi 4, i dekretit të Presidentit të Republikës, të datës 18 qershor 2002, nr. 164, të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Viti 2004	Viti	2005	Në kohë pushimesh (euro)	Në ditë festash ose natën (euro)	Natën në ditë festash (euro)

Nivelet	Kualifikimet/ Pozicionet ekonomike	Parametrat			
IX	Zëvendëskuestor zëvendësues dhe kualifikimet e barazuara	150,00	13,48	15,24	17,58
VIII	Kryekomisar dhe kualifikimet e barazuara	144,50	12,27	13,87	16,01
VIII	Komisar dhe kualifikimet e barazuara	139,00	12,27	13,87	16,01
VII-bis	Zëvendëskomisar Dhe kualifikimet e barazuara	133,25	11,71	13,24	15,27
VII-bis	Inspektor i lartë NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS) zëvendëskomisar dhe kualifikimet e barazuara	139,00	11,71	13,24	15,27
VII-bis	Inspektor i lartë NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)(me 8 vjet në kualifikim) dhe kualifikimet e barazuara	135,50	11,71	13,24	15,27
VII-bis	Inspektor i lartë NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)dhe Kualifikimet e barazuara	133,00	11,71	13,24	15,27
VII	Kryeinspektor dhe kualifikimet e barazuara	128,00	11,21	12,67	14,62
VI-bis	Inspektor dhe kualifikimet e barazuara	124,00	10,74	12,14	14,00
VI	Zëvendësinspektor dhe kualifikimet e barazuara	120,75	10,26	11,60	13,39
VI-bis	Kryeintendent (me 8 vjet në kualifikim	122,50	10,74	12,14	14,00

	dhe kualifikimet e barazuara				
VI-bis	Kryeintendent dhe kualifikimet e barazuara	120,25	10,74	12,14	14,00
VI	Kryeintendent dhe kualifikimet e barazuara	116,25	10,26	11,60	13,39
VI	Zëvendës Kryeintendent dhe kualifikimet e barazuara	112,25	10,26	11,60	13,39
V	Kryeasistent (me 8 vjet në kualifikim) dhe kualifikimet e barazuara	113,50	9,65	10,91	12,59
V	Kryeasistent dhe kualifikimet e barazuara	111,50	9,65	10,91	12,59
V	Asistent dhe kualifikimet e barazuara	108,00	9,65	10,91	12,59
V	Agjent i zgjedhur dhe kualifikimet e barazuara	104,50	9,65	10,91	12,59
V	Agjent dhe Kualifikimet e barazuara	101,25	9,65	10,91	12,59

Neni 4.
Kompensim (shtesë) pensioni

1. Masat e kompensimit (shtesës) të pensionit mujore, të përcaktuara nga neni 5, paragrafi 1, gërma b), i dekretit të Presidentit të Republikës, të datës 18 qershor 2002, nr. 164, janë rritur me shumat mujore bruto si më poshtë vijojnë:

Kualifikimet	Rritjet nga data 01 janar 2004 Euro	Rritje të mëtejshme nga data 01 janar 2005 (Euro)
Zëvendëskuestor zëvendësues dhe kualifikimet e barazuara	45,30	15,90
Kryekomisar dhe kualifikimet e barazuara	44,50	15,60
Komisar dhe kualifikimet e barazuara	44,10	15,40
Zëvendëskomisar dhe kualifikimet e barazuara	42,30	14,80
Inspektor i lartë NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS) dhe kualifikimet e barazuara	43,10	15,10
Kryeinspektor dhe kualifikimet e barazuara	41,10	14,40

Inspektor dhe kualifikimet e barazuara	39,80	14,00
Zëvendësinspektor dhe kualifikimet e barazuara	38,60	13,50
Kryeintendent dhe kualifikimet e barazuara	39,70	13,90
Kryeintendent dhe kualifikimet e barazuara	37,30	13,10
Nënintendent dhe kualifikimet e barazuara	37,10	13,10
Kryeasistent dhe kualifikimet e barazuara	33,40	11,70
Asistent dhe kualifikimet e barazuara	30,40	10,70
Agjent i zgjedhur dhe kualifikimet e barazuara	29,00	10,00
Agjent dhe kualifikimet e barazuara	28,00	10,00

2. Masat e kompensimit (shtesës) të pensionit mujore, që janë përcaktuar nga neni 5, paragrafi 1, gërma b), i dekretit të Presidentit të Republikës, të datës 18 qershor 2002, nr. 164, sikurse janë rritur në mbështetje të paragrafit 1, janë përcaktuar sërish në shumat mujore bruto si më poshtë vijojnë:

Kualifikimet	Nga data 01 janar 2004 Euro	Nga data 01 janar 2005 Euro)
Zëvendëskuestor zëvendësues dhe kualifikimet e barazuara	761,30	777,20
Kryekomisar dhe kualifikimet e barazuara	747,20	762,80
Komisar dhe kualifikimet e barazuara	740,40	755,80
Zëvendëskomisar dhe kualifikimet e barazuara	710,40	725,20
Inspektor i lartë NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS) dhe kualifikimet e barazuara	723,30	738,40
Kryeinspektor dhe kualifikimet e barazuara	690,70	705,10
Inspektor dhe kualifikimet e barazuara	669,20	683,20
Zëvendësinspektor dhe kualifikimet e barazuara	648,30	661,80
Kryeintendent dhe kualifikimet e barazuara	666,20	680,10
Kryeintendent dhe kualifikimet e barazuara	626,80	639,90
Nënintendent dhe kualifikimet e barazuara	623,70	636,80
Kryeasistent dhe kualifikimet e barazuara	561,10	572,80
Asistent dhe kualifikimet e barazuara	510,80	521,50

Agjent i zgjedhur dhe kualifikimet e barazuara	468,40	478,40
Agjent dhe kualifikimet e barazuara	432,20	442,20

Neni 5.
Kompensimet (shtesat) e punës operative për veprimtaritë e lundrimit ajror, të fluturimeve, të pilotimit, të imbarkimit dhe kompensime të tjera.

1. Duke mbetur të pandryshuara dispozitat në fuqi në lidhje me barazimin ndërmjet gradave dhe kualifikimeve të personelit të Forcave të Policisë dhe atij të Forcave të Armatosura, kompensimi i punës operative për veprimtaritë e lundrimit ajror, të fluturimeve, të pilotimit dhe të imbarkimit, si edhe kompensimet përkatëse suplementare që i janë caktuar personelit të Forcave të Policisë me organizim civil, janë raportuar, me të njëjtat mënyra të zbatimit dhe duke mbetur të pandryshuara përqindjet në fuqi të bashkimit të kompensimeve të ndryshme, shumave dhe rritjet në fuqi për personelin e Forcave të Armatosura, i cili punon në të njëjtat kushte operative.

Neni 6.
Kompensime për kryerje shërbimi gjatë ditëve të festave.

1. Duke filluar që nga data 01 janar 2004, për personelin që kryen shërbimin në një ditë feste (pushimi), kompensimi që është parashikuar nga neni 8, paragrafi 2, i dekretit të Presidentit të Republikës, të datës 09 shkurt 2001, nr. 140, është përcaktuar sërish në masën ditore bruto të barabartë me 12,00 Euro.

Neni 7.
Fondi për efektshmërinë e shërbimeve institucionale.

1. Për çdo Forcë të Policisë me organizim civil, Fondi për efektshmërinë e shërbimeve insitucionale, sikurse është parashikuar nga neni 14 të Dekretit të Presidentit të Republikës, të datës 18 qershor 2002, nr. 164, si edhe nga neni 3 i Dekretit të Presidentit të Republikës, të datës 19 nëntor 2003, nr. 348, është rritur me burimet ekonomike vjetore si më poshtë vijojnë:
a) për vitin 2004:
1) Policia e Shtetit: 9.311.000,00 Euro;
2) Trupa e Policisë së Burgjeve: 3.846.000,00 Euro;
3) Trupa e Policisë Pyjore të Shtetit: 699.000,00 Euro;
b) për vitin 2005:
1) Policia e Shtetit: 15.647.000,00;
2) Trupa e Policisë së Burgjeve: 6.341.000,00 Euro;
3) Trupa e Policisë Pyjore të Shtetit: 1.084.000,00 Euro.
2. Shumat e paraqitura më sipër në paragrafin 1 nuk përfshijnë tatimin IRAP (Tatimi Rajonal mbi Aktivitetet Prodhuese) dhe detyrimet për kontributet në ngarkim të Shtetit. Ato që kanë të bëjnë me vitin 2004 nuk e kanë efektin e tërheqjes në vitin pasardhës.
3. Burimet që janë caktuar dhe që nuk janë përdorur në ushtrimin e kompetencës janë caktuar sërish, për të njëjtat nevoja, në vitin pasardhës.

FORCAT E POLICISË ME ORGANIZIM USHTARAK

Neni 8.
Fusha e zbatimit dhe kohëzgjatja

1. Në mbështetje të nenit 2, paragrafi 1, gërma a), të dekretit legjislativ të datës 12 maj 1995, nr. 195, si edhe të ndryshimeve të mëtejshme, ky dekret zbatohet për personelin efektiv të Armës së Karabinierëve, si edhe të Trupës së Policisë Tatimore (Guardia di Finanza), me përjashtim të drejtuesve përkatës dhe të personelit të shërbimit.
2. Ky dekret ka të bëjë me aspektet e rrogave dhe është i vlefshëm për periudhën nga 01 janar 2004 deri në 31 dhjetor 2005.
3. Mbas një periudhe pushimi kontraktor, të barabartë me tre muaj nga data e mbarimit të këtij dekreti, personelit të parashikuar nga paragrafi 1 i paguhet, duke filluar nga muaji pasardhës, një element i përkohshëm i rrogës, i cili është i barabartë me tridhjetë për qind të normës së inflacionit të programuar, që zbatohet për parametrat e rrogave në fuqi. Mbas tre muajsh të tjerë pushimi kontraktor, kjo shumë është e barabartë me pesëdhjetë për qind të normës së inflacionit të programuar dhe dhënia e saj ndërpritet me fillimin e efekteve ekonomike që janë parashikuar nga dekreti i ri i Presidentit të Republikës, i shpallur në mbështetje të nenit 2, paragrafi 1, gërma b), i dekretit legjislativ të datës 12 maj 1995, nr. 195.

Neni 9.
Rrogat e reja

1. Duke filluar nga data 01 janar 2004, rrogat e personelit të Forcave të Policisë me organizim ushtarak, të cilat janë përcaktuar nga neni 42, paragrafi 3, i dekretit të Presidentit të Republikës, të datës 18 qershor 2002, nr. 164, janë rritur me masat mujore bruto dhe janë përcaktuar sërish në vlerat vjetore bruto, sikurse janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nivelet	Rritje mujore bruto (Euro)	Rrogat vjetore bruto sipas tabelës (Euro)
IX	33,90	14.844,14
VIII	30,86	13.013,64
VII-bis	29,53	12.216,25
VII	28,19	11.421,14
VI-bis	27,00	10.703,57
VI	25,81	9.984,79
V	24,28	9.067,95

2. Që nga data 01 janar 2005, vlera e pikës parametrale, sikurse është përcaktuar nga neni 2, paragrafi 4, i dekretit legjislativ të datës 30 maj 2003, nr. 193, është përcaktuar në shumën vjetore bruto të barabartë me 154,50 Euro. Prandaj trajtimi me rrogë i personelit të Forcave të Policisë me organizim ushtarak, i cili është paraqitur në tabelën 4 që i është bashkëlidhur të njëjtit dekret legjislativ, është përcaktuar sërish në masat vjetore bruto të mëposhtme:

Gradat	Parametri	Rrogat vjetore bruto nga data 01 janar 2005 (Euro)
Nënkolonel /Major	150,00	23.175,00
Kapiten	144,50	22.325,25
Toger	139,00	21.475,50

Nëntoger	133,25	20.587,13
Ndihmësmarshall NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS) {Toger} /Ndihmësmarshall {Mëkëmbës/toger}	139,00	21.475,50
Ndihmësmarshall NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)/ Ndihmësmarshall (me 8 vjet në gradë)	135,50	20.934,75
Ndihmësmarshall NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)/ Ndihmësmarshall	133,00	20.548,50
Kryemarshall	128,00	19.776,00
Marshall Efektiv	124,00	19.158,00
Marshall	120,75	18.655,88
Kryebrigadier (me 8 vjet në gradë)	122,50	18.926,25
Kryebrigadier	120,25	18.578,63
Brigadier	116,25	17.960,63
Nënbrigadier	112,25	17.342,63
Tetar i parë i Zgjedhur (me 8 vjet në gradë)	113,50	17.535,75
Tetar i parë i Zgjedhur	111,50	17.226,75
Tetar i parë	108,00	16.686,00
Karabinier i Zgjedhur / Polic Tatimor i Zgjedhur	104,50	16.145,25
Karabinier / Polic Tatimor	101,25	15.643,13

3. Vlerat e rrogave sikurse në paragrafin 2 përvetësojnë rritjet që u janë caktuar që nga data 01 janar 2004, në mbështetje të paragrafit 1.
4. Trajtimi me rroga, sikurse është përcaktuar sërish nga paragrafi 2, për kuotën e pjesës që ka të bëjë me kompensimet plotësuese të posaçme, të grumbulluara që prej datës 01 janar 2005, në vetë trajtimin, në mbështetje të nenit 3, paragrafi 1, të dekretit legjislativ të datës 30 maj 2003, nr. 193, nuk e ndryshon bazën e llogarisë për qëllimet e bazës së pensionit, sikurse është parashikuar nga ligji i datës 29 prill 1976, nr. 177, si edhe nga ndryshimet e mëtejshme, dhe të zbatimit të nenit 2, paragrafi 10, të ligjit të datës 08 gusht 1995, nr. 335, dhe nuk ka efekte të drejtpërdrejta dhe jo të drejpërdrejta mbi trajtimin e përgjithshëm të përfituar, në bazë të dispozitave në fuqi, nga personeli që kryen shërbimin jashtë shtetit.
5. Shumat e përcaktuara nga paragrafët 1 dhe 2 përvetësojnë elementin e përkohshëm të parashikuar të rrogës, në rast pushimi kontraktor, nga neni 2, paragrafi 3, i dekretit të Presidentit të Republikës të datës 18 qershor 2002, nr. 164.

Neni 10.
Efektet e rrogave të reja.

1. Duke mbetur e pandryshuar gjithçka që është parashikuar nga neni 9, paragrafi 4, masat e reja të trajtimit me rroga që rezultojnë nga zbatimi i këtij dekreti me marrëveshje kanë efekt mbi rrogën e trembëdhjetë, mbi trajtimin e zakonshëm të pensionit, normale dhe të privilegjuar, mbi shtesën për vjetërsinë në punë, mbi kompensimin (shtesën) ushqimor që parashikohen nga neni 82 i Dekretit të Presidentit të Republikës të datës 10 janar 1957, nr. 3, ose nga dispozitat e ngjashme, mbi kompensimin e drejtë, mbi ndalesat për sigurimet shoqërore dhe të asistencës dhe në lidhje me kontributet, duke përfshirë ndalesën në llogarinë

e hyrjes të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për Punonjësit e Administratës Publike (INPDAP), ose të tjera të ngjashme, si edhe kontributet e rritjes në gradë dhe në rrogë.
2. Përfitimet ekonomike që rezultojnë nga zbatimi i këtij dekreti janë llogaritur plotësisht, në afatet e mbarimit dhe në shumat e parashikuara, për personelin që sidoqoftë ka ndërprerë shërbimin, me të drejtën e pensionit, në periudhën në të cilën është në fuqi kjo hipotezë marrëveshjeje, me përjashtim të gjithë sa është parashikuar nga paragrafi 3. Efekteve të shtesës për vjetërsinë në punë u merren parasysh vetëm intervalet që janë maturuar deri në datën e ndërprerjes së shërbimit.
3. Për personelin që sidoqoftë e ka ndërprerë shërbimin në vitin 2004, me të drejtën e pensionit, përfitimet e rrogës që rezultojnë nga zbatimi i këtij dekreti janë llogaritur për qëllimet e përcaktimit të trajtimit me pension, për vitin 2004, në shumat e parashikuara nga neni 9, paragrafi 1, dhe, për vitin 2005, në shumat e mëtejshme mujore bruto që janë paraqitur në vijim, në lidhje me gradën e mbuluar, si edhe me pozicionin ekonomik të parashikuar nga tabela B2, e cila i është bashkëlidhur dekretit legjislativ të datës 30 maj 2003, nr. 193, të cilat përkojnë me ato që janë përcaktuar për përmirësimin e rrogave për vitin 2005 të personelit në shërbim me gradë, kualifikim dhe vjetërsi të barabartë:

Gradat dhe pozicionet ekonomike (*)	Niveli	Euro
Nënkolonel Major	IX	32,98
Kapiten	VIII	33,56
Toger	VIII	31,11
Nëntoger	VII-bis	29,88
Ndihmësmarshall NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS){mëkëmbës/toger}\ Ndihmësmarshall{ mëkëmbës/toger }	VII-bis	32,44
Ndihmësmarshall NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)\ Ndihmësmarshall me më shumë se 2 vjet e 4 muaj në gradë dhe marrës i shtesës sipas dekretit legjislativ 83/2001 dhe dekretit legjislativ 67/2001	VII-bis	30,88
Ndihmësmarshall NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)\ Ndihmësmarshall me më shumë se 2 vjet e 4 muaj në gradë dhe jo marrës i shtesës rritje sipas dekretit legjislativ 83/2001 dhe sipas dekretit legjislativ 67/2001	VII-bis	30,88
Ndihmësmarshall NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)\ Ndihmësmarshall me më pak se 2 vjet e 4 muaj në gradë, por marrës i shtesës sipas dekretit legjislativ 83/2001 dhe sipas dekretit legjislativ 67/2001	VII-bis	30,88 |
Ndihmësmarshall NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)SUPS\ Ndihmësmarshall me më pak se 2 vjet e 4 muaj në gradë dhe jo marrës i shtesës sipas dekretit legjislativ 83/2001 dhe sipas dekretit legjislativ 67/2001	VII-bis	29,77
Kryemarshall me më pak se 10 vjet në gradë	VII	28,88

Marshall efektiv me më shumë se 3 vjet e 6 muaj në gradë	VI-bis	28,28
Marshall me më shumë se 1 vit në gradë	VI	28,02
Kryebrigadier me më shumë se 30 vjet shërbimi dhe më shumë se 4 vjet në gradë	VI-bis	27,61
Kryebrigadier me më shumë se 30 vjet shërbimi dhe më pak se 4 vjet në gradë	VI-bis	27,61
Kryebrigadier me më pak se 30 vjet shërbimi dhe më shumë se 4 vjet në gradë	VI-bis	27,61
Kryebrigadier me më pak se 30 vjet shërbimi dhe më pak se 4 vjet në gradë	VI-bis	26,61
Brigadier	VI	26,02
Nënbrigadier me më shumë se 3 vjet e 6 muaj në gradë	VI	24,23
Tetar i Parë i Zgjedhur me më shumë se 16 vjet shërbimi dhe më shumë se 4 vjet në gradë	V	26,32
Tetar i Parë i Zgjedhur me më shumë se 16 vjet shërbimi dhe më pak se 4 vjet në gradë	V	25,43
Tetar i Parë i Zgjedhur me më pak se 16 vjet shërbimi dhe më pak se 4 vjet në gradë	V	25,43
Tetar i Parë	V	23,87
Karabinier i zgjedhur/ Polic Tatimor i Zgjedhur	V	22,31
Karabinier / Polic Tatimor	V	21,44

4. Për qëllimet e përcaktimit të trajtimit me pension, shumat e tabelës së paraqitur në paragrafin 3 nuk prodhojnë efekte mbi shtesat dhe mbi përfitimet që janë paraqitur në nenin 3, paragrafi 1, të dekretit legjislativ të datës 30 maj 2003, nr. 193, që, duke filluar nga data 01 janar 2005, përmblidhen në rrogën që bazohet mbi sistemin e parametrave.
5. Pagesa e rrogave të reja që lindin nga zbatimi i këtij dekreti kryhet, në mënyrë të përkohshme dhe me përjashtim të barazimit, në mbështetje të nenit 172 të ligjit të datës 11 korrik 1980, nr. 312, përsa i përket likuidimit të shpejtë të trajtimit të ri ekonomik.
6. Masat e reja të trajtimit me rrogë, sikurse janë parashikuar në nenin 9, nuk kanë efekt mbi përcaktimin e masave për orët e shpërblimit për punën e zhvilluar jashtë orarit të shërbimit. Masat bruto për orët e shpërblimit për punën e zhvilluar jashtë orarit të shërbimit mbeten ato që janë përcaktuar nga neni 43, paragrafi 4, i dekretit të Presidentit të Republikës, të datës 18 qershor 2002, nr. 164, të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Viti 2004	Viti	2005	Në kohë pushimesh (euro)	Në ditë festash ose natën (euro)	Natën në ditë festash (euro)
Nivelet	Gradat/ Pozicionet ekonomike	Parametrat			
IX	Nënkolonel / Major	150,00	13,48	15,24	17,58
VIII	Kapiten	144,50	12,27	13,87	16,01
VIII	Toger	139,00	12,27	13,87	16,01
VII-bis	Nëntoger	133,25	11,71	13,24	15,27
VII-bis	Ndimësmarshall NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS) {Mëkëmbës/toger}/ Ndihmësmarshall {Mëkëmbës/toger}	139,00	11,71	13,24	15,27
VII-bis	Ndimësmarshall |NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)/ Ndihmës Marshall(me 8 vjet në gradë)	135,50	11,71	13,24	15,27
VII-bis	Ndihmësmarshall NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)/ Ndihmësmarshall	133,00	11,71	13,24	15,27
VII	Kryemarshall	128,00	11,21	12,67	14,62
VI-bis	Marshall Efektiv	124,00	10,74	12,14	14,00
VI	Marshall	120,75	10,26	11,60	13,39
VI-bis	Kryebrigadier (me 8 vjet në gradë)	122,50	10,74	12,14	14,00
VI-bis	Kryebrigadier	120,25	10,74	12,14	14,00
VI	Brigadier	116,25	10,26	11,60	13,39
VI	Nënbrigadier	112,25	10,26	11,60	13,39
V	Tetar i Parë i Zgjedhur (me 8 vjet në gradë)	113,50	9,65	10,91	12,59
V	Tetar i Parë i Zgjedhur	111,50	9,65	10,91	12,59
V	Tetar i Parë	108,00	9,65	10,91	12,59
V	Karabinier i Zgjedhur / Polic Tatimor i Zgjedhur	104,50	9,65	10,91	12,59

Neni 11.
Kompensim (shtesë) pensioni
1. Masat e kompensimit (shtesës) mujor të pensionit, të cilat janë përcaktuar nga neni 44, paragrafi 1, gërma b), e dekretit të Presidentit të Republikës, të datës 18 qershor 2002, nr. 164, janë rritur me shumat mujore bruto si më poshtë vijojnë:

Gradat	Rritjet nga data 01 janar 2004 Euro	Rritje të mëtejshme nga data 01 janar 2005 (Euro)
Nënkolonel dhe Major	45,30	15,90
Kapiten	44,50	15,60
Toger	44,10	15,40
Nëntoger	42,30	14,80
Ndihmësmarshall NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)dhe Ndihmësmarshall	43,10	15,10
Kryemarshall	41,10	14,40
Marshall Efektiv	39,80	14,00
Marshall	38,60	13,50
Kryebrigadier	39,70	13,90
Brigadier	37,30	13,10
Nënbrigadier	37,10	13,10
Tetar i Parë i Zgjedhur	33,40	11,70
Tetar i Parë	30,40	10,70
Karabinier i Zgjedhur / Polic Tatimor i Zgjedhur	29,00	10,00
Karabinier/ Polic Tatimor	28,00	10,00

2. Masat e kompensimit (shtesës) mujor të pensionit që janë përcaktuar nga neni 44, paragrafi 1, gërma b), i dekretit të Presidentit të Republikës, të datës 18 qershor 2002, nr. 164, sikurse janë rritur në mbështetje të paragrafit 1, janë përcaktuar sërish në shumat mujore bruto si më poshtë vijojnë:

Kualifikimet	Nga data 01 janar 2004 Euro	Nga data 01 janar 2005 Euro)
Nënkolonel dhe Major	761,30	777,20
Kapiten	747,20	762,80
Toger	740,40	755,80
Nëntoger	710,40	725,20
Ndihmësmarshall NËNOFICER I SIGURISË PUBLIKE (SUPS)dhe Ndihmësmarshall	723,30	738,40
Kryemarshall	690,70	705,10
Marshall Efektiv	669,20	683,20
Marshall	648,30	661,80
Kryebrigadier	666,20	680,10
Brigadier	626,80	639,90
Nënbrigadier	623,70	636,80
Tetar i Parë i Zgjedhur	561,10	572,80
Tetar i Parë	510,80	521,50
Karabinier i Zgjedhur /	468,40	478,40

Polic Tatimor i Zgjedhur		
Karabinier/ Polic Tatimor	432,20	442,20

Neni 12.
Kompensimet (shtesat) e punës operative për veprimtaritë e lundrimit ajror, të fluturimeve, të pilotimit, të imbarkimit dhe kompensime të tjera.

1. Duke mbetur të pandryshuara dispozitat në fuqi në lidhje me barazimin ndërmjet gradave dhe kualifikimeve të personelit të Forcave të Policisë dhe atij të Forcave të Armatosura, kompensimi i punës operative për veprimtaritë e lundrimit ajror, të fluturimeve, të pilotimit dhe të imbarkimin, si edhe kompensimet përkatëse suplementare që i janë caktuar personelit të Forcave të Policisë me organizim ushtarak, janë raportuar, me të njëjtat mënyra të zbatimit dhe duke mbetur të pandryshuara përqindjet në fuqi të bashkimit të kompensimeve të ndryshme, shumave dhe rritjet në fuqi për personelin e Forcave të Armatosura, i cili punon në të njëjtat kushte operative.

Neni 13.
Kompensime për kryerje shërbimi gjatë ditëve të festave.

1. Duke filluar që nga data 01 janar 2004, për personelin që kryen shërbimin në një ditë feste (pushimi), kompensimi që është parashikuar nga neni 20, paragrafi 2, i dekretit të Presidentit të Republikës, të datës 09 shkurt 2001, nr. 140, është përcaktuar sërish në masën ditore bruto të barabartë me 12,00 Euro.

Neni 14.
Efektshmëria e shërbimeve institucionale.

1. Për çdo Forcë të Policisë me organizim ushtarak, Fondi për efektshmërinë e shërbimeve insitucionale, sikurse është parashikuar nga neni 53 të Dekretit të Presidentit të Republikës, të datës 18 qershor 2002, nr. 164, si edhe nga neni 8 i Dekretit të Presidentit të Republikës, të datës 19 nëntor 2003, nr. 348, është rritur me burimet ekonomike vjetore si më poshtë vijojnë:

a) për vitin 2004:
1) Arma e Karabinierëve: 10.539.000,00 Euro;
2) Trupa e Policisë Tatimore (Guardia di finanza): 5.906.000,00 Euro;
b) për vitin 2005:
1) Arma e Karabinierëve: 17.832.000,00 Euro;
2) Trupa e Policisë Tatimore (Guardia di finanza) 9.615.000,00 Euro.

2. Shumat e paraqitura më sipër në paragrafin 1 nuk përfshijnë tatimin IRAP (Tatimi Rajonal mbi Aktivitetet Prodhuese) dhe detyrimet për kontributet në ngarkim të Shtetit. Ato që kanë të bëjnë me vitin 2004 nuk e kanë efektin e tërheqjes në vitin pasardhës.

3. Burimet që janë caktuar dhe që nuk janë përdorur në ushtrimin e kompetencës janë caktuar sërish, për të njëjtat nevoja, në vitin pasardhës.

Titulli III
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE
Neni 15.
Shtyrja e afatit të efektshmërisë së normave

1. Për personelin për të cilin bëhet fjalë në titujt I dhe II, vazhdojnë të zbatohen, në rastet kur nuk është në kundërshtim me këtë dekret, normat e përcaktuara nga masat e mëparshme të përvetësimit të marrëveshjeve dhe të hartimit.

Neni 16.
Mbulimi financiar

1. Detyrimi që buron nga zbatimi i këtij dekreti, i vlerësuar me 399.950.000 Euro, për vitin 2004, si edhe me 636.315.000 Euro duke filluar që nga viti 2005, përmbushet me përdorimin e autorizimeve të shpenzimeve që janë parashikuar nga neni 3, paragrafi 47, i ligjit të datës 24 dhjetor 2003, nr. 350, të regjistruara në kuadrin e njësisë së parashikimit bazë 4.1.5.4. «Fondet që duhet të ndahen për detyrimet për personelin », në kapitullin 3027 të gjendjes së parashikimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për të njëjtët vite.
2. Ministri i ekonomisë dhe i financave është i autorizuar që t'i bëjë ndryshimet e nevojshme bilancit, me anën e dekreteve të veta.
Ky dekret, i pajisur me vulën e Shtetit, do të përfshihet në Përmbledhjen zyrtare të akteve ligjore të Republkës Italiane. Është detyrim i kujtdo që i takon ta respektojë dhe që të kujdeset për respektimin e tij nga të tjerët.
I shpallur në Romë, në datën 05 nëntor 2004.
CIAMPI
Berlusconi, Kryetar i Këshillit të Ministrave
Mazzella, Ministër për funksionin publik
Pisanu, Ministër i Punëve të Brendshme
Martino, Ministër i Mbrojtjes
Castelli, Ministër i Drejtësisë
Alemanno, Ministër i Politikave Bujqësore dhe Pyjore
Siniscalco, Ministër i Ekonomisë dhe i Financave
U shikua, Ministri i Drejtësisë: Castelli
U regjistrua në Gjykatën e Llogarive, në datën 10 dhjetor 2004
Ministritë institucionale, regjistri nr. 12, fleta nr. 15.